

VENDIM
Nr.46, datë 29.2.2008

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME
PËR KRYETAR KOMUNE, KOMUNA PASKUQAN, TË DATËS 24.2.2008”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij, të datës 29.02.2008, me pjesëmarrjen e:

Çlirim	Gjata	Kryetar
Flamur	Çato	Zëvendëskryetar
Arben	Ristani	Anëtar
Dodë	Prenga	Anëtar
Fatmir	Kumbaro	Anëtar
Klement	Zguri	Anëtar
Shkëlqim	Hysi	Anëtar

shqyrtoi çështjen me

OBJEKTI: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.2.2008.

BAZA LIGJORE: Neni 2, pika 34 germa “a”, neni 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në datën 24.2.2008, në komunën Paskuqan, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e komunës. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave nga grupet e numërimit, KZQV-komuna Paskuqan miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe me vendim shpalli fitues z.Fatos Rexha. Kundër vendimit të KZQV-së Paskuqan, brenda afatit ligjor, nuk pati në KQZ asnjë ankim zgjedhor nga asnjë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.02.2008.

Në referim të përcaktimeve të nenit 29 dhe nenit 2, pika 34, germa ”a” të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 2, pika 34 germa “a”, nenin 29, pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për kryetar komune, komuna Paskuqan, të datës 24.2.2008, duke shpallur fitues z.Fatos Hasan Rexha, kandidat i mbështetur nga Partia Demokratike.